



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo -Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura IV**  
**Kuvendi**

Në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6.1 të Rregullores së Kuvendit,

Duke marrë parasysh:

Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (1948);

Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj;

Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare si dhe Instrumentet tjera Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut;

Gjendjen jo të mire politike, ekonomike, diskriminimin, cenimin e të drejtave dhe lirisë së shprehjes, mohimin e kultivimit të identitetit, kulturës, gjuhës dhe promovimit të vlerave tjera kombëtare dhe historike të shqiptarëve në Luginën e Preshevës (Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë);

Duke përfshirë platformën politike për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë të vitit 2006, deklaratën e 12 janarit 2013 dhe dokumentin e masave urgjente të shkurtit 2013;

Duke kërkuar që Institucionet e Republikës së Kosovës duhet të kenë më shumë kujdes dhe interesim gjithëpërfshirës për përmirësimin e gjendjes së shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë;

Duke pasur parasysh mos zbatimin e Marrëveshjes së Konçulit e cila ndali luftën çlirimtare të UÇPMB-së dhe forcave ushtarake dhe policore të Serbisë;

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 31 maj dhe 6 qershor 2013, miratoi këtë

**R E Z O L U T Ë**

**PËR TË DREJTAT E SHQIPTARËVE NË PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të kushtëzojë marrëdhëniet me Serbinë, me kujdesin dhe interesimin shtetëror për përmirësimin e gjendjes së shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë lidhur me të drejtat e tyre civile, politike dhe etnike;

2. Qeveria e Republikës së Kosovës të ketë më shumë përkujdesje dhe trajtim më të mirë për qytetarët shqiptarë të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, të cilët janë shpërngulur në Kosovë duke iu garantuar të drejta të plota dhe të barabarta;
3. Qeveria e Republikës së Kosovës të hapë një zyre në Prishtinë dhe në Gjilan për qytetarët e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes dhe atyre të cilët janë shpërngulur nga atje sipas normave ndërkombëtare;
4. Të krijohen lehtësi të qarkullimit, shkollimit, afirmimit kulturor, pajisjeve me dokumente përkatëse si dhe lehtësi tjera, duke përfshirë suspendimin e taksës diskriminuese;
5. Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkon nga institucionet ndërkombëtare dhe institucionet relevante që të liroj të burgosurit politikë duke përfshirë të ashtuquajturin grupin e Gjilanit që janë viktima të një procesi të montuar politik;
6. Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkoj reciprocitet të plotë me të drejtat e serbëve pakicë në veri të Kosovës;
7. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet nismën e themelimit të një Universiteti Publik në gjuhën shqipe dhe fton përfaqësuesit politikë dhe institucionalë të marrin nismë ligjore;
8. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet themelimin e fondit zhvillimor për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë me iniciativën e Qeverisë së Kosovës dhe në koordinim me institucionet ndërkombëtare dhe evropiane;
9. Kuvendi i Republikës së Kosovës fton Këshillin e Evropës dhe organizatat tjera ndërkombëtare që të angazhohen për detyrimin e Republikës së Serbisë për të respektuar të gjitha të drejtat që dalin nga Konventat ndërkombëtare;
10. Qeveria e Republikës së Kosovës të themelon grupin ndërministror për implementim që përfshin edhe vizitën e mundshme të Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian dhe Ministrisë për Integritet Evropian.

Nr. 04-R-011

Prishtinë, më 6 qershor 2013

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

Cc:

- Presidentes së Republikës së Kosovës,
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës,
- Arkivit të Kuvendit.